




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



VENDIM

Nr. 730, datë 20.10.2016

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET, KRITERET,
TARIFAT, AFATET DHE PROCEDURËN PËR KLASIFIKIMIN
E STRUKTURAVE AKOMODUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 45, të ligjit nr.93/2015, "Për turizmin", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese si dhe të kriterëve për klasifikimin e strukturave akomoduese, të përcaktuara në aneksin 1, të këtij vendimi.
2. Rregullorja nr.2, datë 20.3.2003, "Për kriteret, kushtet dhe procedurat për licencimin e ushtrimit të veprimtarisë turistike akomoduese, regjistrimin dhe klasifikimin e njësive akomoduese turistike", miratuar me urdhrin nr.43, datë 20.3.2003, të ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, shfuqizohet.
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2016.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

MILVA EKONOMI

RREGULLORE

PËR KUSHTET, KRITERET, TARIFAT, AFATET DHE PROCEDURËN PËR KLASIFIKIMIN E STRUKTURAVE AKOMODUESE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore përcakton:

1. kushtet dhe kriteret për klasifikimin e strukturave akomoduese;
2. procedurat, afatet dhe strukturat administrative për klasifikimin e strukturave akomoduese;
3. tarifat e aplikimit dhe kostot e verifikimit për marrjen e certifikatës së klasifikimit për secilën kategori të strukturave akomoduese.

Neni 2 Fusha e Zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për strukturat akomoduese të përcaktuara në ligjin nr.93/2015, “Për Turizmin”.
2. Përjashtohen nga procesi i klasifikimit të parashikuar në këtë rregullore strukturat akomoduese që përbëjnë objekt të veçantë të trashëgimisë kulturore.

Neni 3 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr.93/2015, “Për turizmin”.
2. Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) **“Aplikim elektronik”**, portali elektronik i ministrisë përgjegjëse për turizmin, i aksesueshëm nëpërmjet portalit të shërbimeve shtetërore elektronike, ku mundësohet aplikimi për klasifikimin e strukturave akomoduese dhe plotësimi i formularit të vetëdeklarimit, nëpërmjet mjeteve elektronike;

- b) **“Bujtinë”** (shtëpi pritëse), një strukturë akomoduese, një ndërtesë, një pjesë e së cilës përdoret si rezidencë e pronarit dhe ku ofrohet akomodim dhe ushqim për vizitorët, përkundrejt pagesës;
- c) **“Certifikatë klasifikimi”**, dokumenti i lëshuar nga komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike për klasifikimin e strukturës akomoduese;
- ç) **“Fjetinë”** (Hostel), ndërtesë që ofron akomodim dhe ushqim me çmime ekonomike, zakonisht për udhëtarë, studentë e punëtorë, ku dhoma ndahet mes disa klientëve të ndryshëm;
- d) **“Fjetje dhe mëngjes (B&B)”**, strukturë akomoduese që ofron shërbimin e fjetjes dhe të mëngjesit brenda çmimit të dhomës. Kjo strukturë akomoduese nuk ofron shërbim restoranti dhe ambiente të përbashkëta;
- dh) **“Hotel”**, ndërtesë me jo më pak se 6 dhoma, ku akomodimi dhe shërbimet si ushqim, pije etj. ofrohen nga një staf i kualifikuar, kundrejt një çmimi të afishuar;
- e) **“Kamping”**, zonë publike ose private e rrethuar, e pajisur me infrastrukturë të domosdoshme (ujë, tualete, energji elektrike etj.), ku udhëtarët mund të akomodohen në tendat e kampingut apo të ngrenë tendat e tyre, ose të parkojnë mjetin motorik akomodues (kamper);
- ë) **“Qendër kurative”**, strukturë akomoduese me vendndodhje në zona me potenciale kuruese natyrore, të cilat stimulohen nga toka, uji, deti, rëra e klima dhe që shërbejnë për kryerjen e terapive kuruese;
- f) **“Strukturë akomoduese”**, struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, për një periudhë kohe të pacaktuar, por jo më shumë se 1 vit, shërbimet e akomodimit (fjetje, ushqim, pije dhe shërbime të tjera), në përputhje me standardet e përcaktuara sipas klasifikimit dhe kategorizimit të saj;
- g) **“Regjistri qendror i turizmit”**, regjistri publik i sipërmarrjeve turistike, që mbahet sipas parashikimeve të ligjit nr.93/2015, “Për Turizmin”, dhe që ka qëllime statistikore;
- gj) **“Resort”**, kompleks ndërtesash për pushim dhe argëtim, të grupuara e të administruara së bashku, si hotele, apartamente, vila, studio, që u ofron klientëve akomodim, ushqim, pije, veprimtari sportive e argëtuese dhe shërbime ndihmëse, nëpërmjet një stafi të kualifikuar;
- h) **“Motel”**, ndërtesë që ofron shërbim akomodimi dhe parkimi, zakonisht me synimin për qëndrim të shkurtër të udhëtarëve, me vendndodhje në periferi të qendrave të banuara, pranë kryqëzimeve dhe rrugëve automobilistike;
- i) **“Sipërmarrës turistik”**, personi fizik ose juridik, i krijuar sipas ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, që kryen veprimtari turistike;
- j) **“Komisioni”**, komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike, i cili ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, me urdhër të ministrit, sipas përcaktimeve të nenit 18, të ligjit nr.93/2015, “Për turizmin”;

- k) **“Ligji”**, ligji nr.93/2015, “Për turizmin”, siç mund të ndryshohet herë pas here;
- l) **“Ministri”**, ministri përgjegjës për turizmin;
- ll) **“Ministria”**, ministria përgjegjëse për turizmin;
- m) **“Inspektorati”**, inspektorati që mbulon fushën e turizmit, në përputhje me ligjin;
- n) **“Sistem klasifikimi”**, ndarja e llojeve të ndryshme të strukturave akomoduese në kategori, duke u bazuar në një sërë kriteresh, të cilat kanë të bëjnë me kushtet fizike të objektit ku ushtrohet veprimtaria si strukturë akomoduese si dhe me shërbimet që kjo strukturë ofron.

KREU II

KATEGORITË DHE KLASIFIKIMI I STRUKTURAVE AKOMODUESE

Neni 4

Kategoritë e strukturave akomoduese

1. Çdo sipërmarrës turistik, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të pajiset me certifikatë klasifikimi për ushtrimin e këtij aktiviteti.
2. Strukturat akomoduese kategorizohen, si më poshtë vijon:
 - a) “Bujtinë”;
 - b) “Fjetinë” (Hostel);
 - c) “Kamping”;
 - ç) “Hotel”;
 - d) “Motel”;
 - dh) “Resort”;
 - e) “Qendër kurative”;
 - ë) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Neni 5

Klasifikimi i strukturave akomoduese

1. Komisioni kategorizon dhe klasifikon çdo strukturë akomoduese, mbështetur në kushtet dhe kriteret e parashikuar nga kjo rregullore dhe të aneksit nr.1, “Kushtet dhe kriteret e klasifikimit”, bashkëlidhur.
2. Për strukturat akomoduese “hotele”, certifikata e klasifikimit, sipas nivelit përkatës, lëshohet kur plotësohet totali i pikëve të kërkuara për secilin nivel klasifikimi, sipas aneksit 1/d. Pikët përfitohen nga:
 - plotësimi i kriterëve të detyrueshme, referuar nivelit përkatës;
 - plotësimi i disa prej kriterëve me zgjedhje.

3. Për strukturat e tjera akomoduese, certifikata e klasifikimit, sipas nivelit përkatës, lëshohet kur plotësohen kriteret e detyrueshme për secilin nivel.
4. Ministri përgjegjës për turizmin miraton, me udhëzim, manualin shpjegues të kriterëve të klasifikimit për çdo kategori.

KREU III

PROCEDURA PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS

Neni 6

Kërkesa për pajisjen me certifikatë klasifikimi

1. Sipërmarrësi turistik, që ushtron veprimtarinë strukturë akomoduese, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë klasifikimi, duke plotësuar në sistemin elektronik të turizmit formularin e vetëdeklarimit, të miratuar me urdhër të Ministrit. Sipërmarrësi turistik mban përgjegjësi për vërtetësinë e të dhënave të deklaruara.
2. Me dërgimin e formularit, kërkuksi pajiset me një numër aplikimi të gjeneruar nga sistemi.
3. Gjatë procedurës për pajisjen me certifikatë klasifikimi, sipërmarrësi turistik mund të ushtrojë veprimtarinë si strukturë akomoduese.

Neni 7

Procesi i verifikimit

1. Për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruara nga kërkuksi, Ministria bashkëpunon me agjenci dhe organizata ndërkombëtare të mirënjohura në fushën e vlerësimit të strukturave akomoduese, të cilat, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me Ministrinë, kryejnë vlerësimin për klasifikimin e strukturës akomoduese.
2. Me marrjen e aplikimit, Ministria njofton kërkuksin për kryerjen e pagesës së tarifës së verifikimit në llogarinë e Ministrisë, në llogarinë e unifikuar të thesarit të shtetit.
3. Brenda 5 ditëve nga kryerja e pagesës së tarifës së verifikimit, Ministria njofton kërkuksin për datën/datat e caktuara për verifikimin e kushteve dhe kriterëve që plotësohen nga struktura akomoduese. Data për verifikimin caktohet, të paktën, 5 ditë pas njoftimit të kërkuksit nga Ministria.
4. Procesi i verifikimit të përmbushjes së kriterëve përkatëse nga struktura akomoduese kryhet nga jo më pak se dy persona dhe duhet të përfundojë

brenda 30 ditëve, nga dita e njoftimit të kërkuarit për datën/datat e verifikimit.

5. Procesi i verifikimit përfshin një ose më shumë vizita pranë strukturës akomoduese, të cilat duhet të kryhen brenda afatit të parashikuar në pikën 3, të këtij neni.
6. Me përfundimin e procesit të verifikimit, formulari i plotësuar nga verifikuesit në sistemin elektronik mund të aksesohet nga Komisioni dhe nga kërkuari, nëpërmjet numrit të tij të aplikimit.
7. Kërkuari, brenda 5 ditëve nga ngarkimi në sistem i formularit të plotësuar të verifikimit, mund t'i paraqesë, me shkrim, Komisionit, kundërshtimet e tij për rezultatet e verifikimit.
8. Në rast se kërkuari ka kundërshtuar rezultatet e verifikimit, Komisioni, brenda 15 ditëve nga paraqitja e këtij kundërshtimi, vendos nëse është e nevojshme kryerja e një verifikimi të strukturës ose zgjedhja e një vlerësuesi tjetër. Në rast të kundërt, Komisioni, në vendimin e tij, argumenton edhe arsyet e mosmarrjes në konsideratë të kundërshtimit të kërkuarit.

Neni 8

Vendimi i Komisionit

1. Komisioni, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të formularit të verifikimit, shqyrton dhe vlerëson, në mënyrë tërësore, dokumentet dhe të dhënat e paraqitura nga kërkuari, rezultatet e verifikimit si dhe përmbushjen e kriterëve të kërkuara për klasifikimin e strukturës akomoduese.
2. Komisioni ka të drejtë ta shtyjë afatin e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, në mënyrë të arsyetuar, me jo më shumë se 60 ditë, duke i dërguar kërkuarit një njoftim me shkrim, jo më vonë se përfundimi i afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni.
3. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, Komisioni, sipas rastit, vendos:
 - a) lëshimin e certifikatës së klasifikimit, e cila përcakton kategorinë dhe nivelin përkatës të strukturës akomoduese;
 - b) Dhënien, vetëm një herë, të një afati deri në 60 ditë për plotësimin e mangësive dhe kushteve minimale për lëshimin e certifikatës së klasifikimit. Verifikimi i përmbushjes së kushteve dhe kriterëve minimale për lëshimin e certifikatës së klasifikimit pas përfundimit të këtij afati kryhet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8.

4. Në rast të mospërbushjes së kushteve minimale për lëshimin e certifikatës së klasifikimit pas përfundimit të afatit të parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij neni, Komisioni vendos refuzimin e kërkesës për certifikatë klasifikimi.
5. Vendimi i Komisionit duhet të jetë i arsyetuar dhe të përmbajë kriteret e përmbushura nga struktura akomoduese si dhe kategorinë e nivelin e përcaktuar për këtë strukturë.
6. Ndaj vendimit të Komisionit lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi ndaj vendimit të Komisionit nuk sjell pezullimin e zbatimit të tij. Në rast se Komisioni vendos refuzimin e kërkesës për certifikatë klasifikimi, sipërmarrësi turistik mund të ushtrojë veprimtarinë si strukturë akomoduese deri në marrjen e një vendimi gjykate të formës së prerë, por nuk ka të drejtë të afishojë shenjat dalluese të klasifikimit të strukturës akomoduese.
7. Pas refuzimit të kërkesës për lëshimin e certifikatës së klasifikimit, kërkuuesi ka të drejtë të paraqesë kërkesën e tij për ta nisur procesin përsëri vetëm pasi të kenë kaluar 90 ditë nga refuzimi, dhe do të trajtohet si kërkesë e paraqitur për herë të parë.

Neni 9

Lëshimi i certifikatës së klasifikimit

1. Komisioni, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit për përcaktimin e kategorisë dhe nivelit të klasifikimit, përgatit certifikatën e klasifikimit dhe njofton, me shkrim, kërkuuesin, për vendimin e marrë.
2. Certifikata e klasifikimit nënshkruhet nga Ministri dhe përmban:
 - a) emrin e shoqërisë dhe emërtimin e strukturës akomoduese;
 - b) kategorinë dhe nivelin e klasifikimit;
 - c) datën e lëshimit të certifikatës së klasifikimit;
 - ç) afatin e vlefshmërisë.
3. Kërkuuesi duhet të tërheqë certifikatën e klasifikimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, në të kundërt, ai do të konsiderohet i paklasifikuar nga autoritetet e kontrollit dhe të inspektimit dhe do të mbajë përgjegjësi administrative, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Certifikata e klasifikimit, e lëshuar dhe e miratuar nga Komisioni, sipas formatit dhe modelit bashkëngjitur në aneksin nr.2, është tregues i cilësisë

së strukturës akomoduese dhe afishohet në recepsionin e strukturës akomoduese.

5. Shenja dalluese e klasifikimit sipas cilësisë, e prodhuar sipas formatit dhe modelit të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin, vendoset në hyrjen kryesore të strukturës akomoduese.
6. Certifikata e klasifikimit regjistrohet automatikisht, pas përfundimit të procesit të klasifikimit, në Regjistrin Qendror të Turizmit, që administrohet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.

KREU IV

RINOVIMI, NDRYSHIMI DHE REVOKIMI I CERTIFIKATËS

Neni 10

Vlefshmëria e certifikatës

1. Afati i vlefshmërisë së certifikatës së klasifikimit është 4 vjet, nga data e lëshimit të saj, me të drejtë rinovimi.
2. Për rinovimin e certifikatës së klasifikimit sipërmarrësi turistik dorëzon kërkesën përkatëse jo më vonë se 30 ditë përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë së saj.
3. Procedura për lëshimin e certifikatës së klasifikimit, e parashikuar në këtë rregullore, do të zbatohet edhe në rastin e rinovimit të certifikatës së klasifikimit.
4. Gjatë procedurës së rinovimit, certifikata e klasifikimit, së cilës i ka kaluar afati i vlefshmërisë, do të konsiderohet e vlefshme deri në përfundim të afateve të parashikuara në këtë rregullore për shqyrtimin e kërkesës për rinovimin e saj.

Neni 11

Riklasifikimi i strukturës akomoduese

1. Me kërkesë të sipërmarrësit turistik, Komisioni mund të nisë procedurat për rivlerësimin dhe riklasifikimin e strukturës akomoduese, me qëllim ngritjen e nivelit të klasifikimit.
2. Kërkesa për riklasifikim nuk mund të paraqitet më parë se 12 muaj nga data e lëshimit të certifikatës së klasifikimit. Procedura për lëshimin e certifikatës së klasifikimit, e parashikuar në këtë rregullore, zbatohet edhe për riklasifikimin e strukturës akomoduese.

Neni 12

Ndryshimi i certifikatës së klasifikimit

1. Sipërmarrësi turistik, që pajiset me certifikatë klasifikimi nga Komisioni, duhet të njoftojë Ministrinë për çdo ndryshim në të dhënat e paraqitura për marrjen e saj ose çdo ndryshim që mund të ndikojë në klasifikimin e strukturës akomoduese brenda 7 ditëve, nga ndodhja e tyre.
2. Në rast se Komisioni e çmon të arsyeshme se ndryshimet e njoftuara nga sipërmarrësi turistik mund të ndikojnë në klasifikimin e strukturës akomoduese, Komisioni mund të nisë procedurën e rivlerësimit kryesisht, në përputhje me nenin 13, të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Rivlerësimi kryesisht

1. Komisioni mund të nisë procedurën e rivlerësimit kryesisht në këto raste:
 - a) Me kërkesë të inspektoratit, të shoqëruar me aktin e inspektimit, në rastet kur struktura akomoduese, në mënyrë të përsëritur, nuk përmbush kushte dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në akte të tjera në zbatim të Ligjit;
 - b) Kur struktura akomoduese ka njoftuar Komisionin për ndryshime që ndikojnë në uljen e klasifikimit të saj.
2. Vendimi i Komisionit për hapjen e procedurës së rivlerësimit kryesisht duhet të jetë i arsyetuar dhe të përmbajë arsyet për rivlerësimin kryesisht të strukturës akomoduese.
3. Ndaj vendimit të Komisionit lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi ndaj vendimit të Komisionit nuk sjell pezullimin e zbatimit të tij.

Neni 14

Revokimi i certifikatës

1. Komisioni mund të revokojë certifikatën e klasifikimit të strukturës akomoduese në rast se:
 - a) nga inspektorati konstatohen shkelje të rënda ose ndryshime thelbësore në kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë struktura akomoduese sipas certifikatës së lëshuar të klasifikimit;

- b) konstatohen të dhëna të rreme në dokumentet e aplikimit të sipërmarrësit turistik;
 - c) pas procedurës së rivlerësimit kryesisht, struktura akomoduese nuk përmbush kushtet dhe kriteret e nivelit më të ulët të sistemit të klasifikimit, të përcaktuara në tabelën e klasifikimit të kategorisë përkatëse, sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.
2. Vendimi i Komisionit për revokimin e certifikatës së klasifikimit duhet të jetë i arsyetuar. Ndaj vendimit të Komisionit lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda afateve dhe sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Në këtë rast, sipërmarrësi turistik mund të ushtrojë veprimtarinë si strukturë akomoduese deri në marrjen e një vendimi gjykate të formës së prerë, por nuk ka të drejtë të afishojë shenjat dalluese të klasifikimit të strukturës akomoduese.

Neni 15

Detyrat dhe përgjegjësitë e sipërmarrësit turistik

Sipërmarrësi turistik duhet të:

- a) ofrojë një shërbim profesional të kujdesshëm e të përkushtuar, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet nënligjore në zbatim të Ligjit;
- b) përfshijë në materialet promovuese, reklamat ose promocionet e ndryshme kategorinë, nivelin dhe shenjat dalluese të klasifikimit të strukturës akomoduese, në përputhje me certifikatën e klasifikimit;
- c) lejojë kontrollin në mjediset dhe në dokumentacionin përkatës si dhe të vërë në dispozicion të Inspektoratit, Komisionit ose vlerësuesve informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për inspektim;
- ç) afishojë informacion për destinacionet turistike kulturore në afërsi të strukturës akomoduese.

KREU V

TARIFAT E KLASIFIKIMIT

Neni 16

Tarifat për klasifikimin e strukturave akomoduese

1. Kërkuesi, për aplikimin për klasifikim, riklasifikim ose rinovim të vlerësimit të strukturës akomoduese si dhe për lëshimin e certifikatës së klasifikimit do të paguajë tarifën në shumën 100 (njëqind) lekë.

2. Kostot e procesit të verifikimit për klasifikimin e strukturës akomoduese mbulohet nga sipërmarrjet turistike që aplikojnë për pajisjen me certifikatë klasifikimi.
3. Tarifat për verifikimin në terren (në lekë) janë, si më poshtë vijon:

Kategoria	Kosto për dhomë	Tarifa minimale për strukturë	Tarifa maksimale për strukturë
Bujtinë	900	1 500	10 000
Hotel	1 200	4 500	100 000
Motel	900	3 150	75 000
Resort	1 200	4 500	120 000
Qendër kurative	1 200	4 050	75 000
Fjetje dhe mëngjes	900	1 170	9 600
	Kosto për njësi		
Bujtinë me vetëshërbim	1 200	2 000	30 000
Kamping	60	3 000	15 000
	Kosto për shtrat		
Fjetinë	90	3 150	20 000

4. Të ardhurat nga tarifat për aplikimin dhe verifikimin për klasifikimin e strukturave akomoduese derdhen për llogari të ministrisë përgjegjëse për turizmin në llogarinë e unifikuar të thesarit të shtetit.

ANEKSI NR. 1

KUSHTET DHE KRITERET E KLASIFIKIMIT

Aneksi 1/a – Tabela e klasifikimit – Bujtinë

Aneksi 1/b – Tabela e klasifikimit – Fjetinë

Aneksi 1/c – Tabela e klasifikimit – Kamping

Aneksi 1/d – Tabela e klasifikimit – Hotel

Aneksi 1/e – Tabela e klasifikimit – Motel

Aneksi 1/f – Tabela e klasifikimit – Resort

Aneksi 1/g – Tabela e klasifikimit – Qendër Kurative

Aneksi 1/h – Tabela e klasifikimit – Fjetje dhe Mëngjes

Aneksi 1/a

Tabelë klasifikimi - Bujtina

Në mënyrë që një strukturë akomoduese të klasifikohet si “Bujtinë” duhet që të përmbushë të gjithë kriteret e listuara më poshtë.		
Fushat	Nr.	Kriteret
Klasifikimi Standard		
I. Të dhëna të përgjishme mbi bujtinën		
Ndërtesa	1	Bujtina është një godinë që ka kryesisht stil tradicional rajonal, të integruara në mjedisin rrethues - përputhen me traditën dhe arkitekturën lokale të vendit.
	2	Dekorë sipas stilit lokal (Dekorimet janë në stilin tradicional, tipik të rajonit / vendit.
	3	Kur dekorimet janë funksionale, ato nuk duhet të paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë.)
	4	Sendet personale të pronarëve të shtëpisë pritëse nuk duhet të jenë në ambientet që shfrytëzohen nga klientët
Mirëmbajtja, Pastërtia dhe Siguria	5	Gjendja e ndërtesës të jetë e qendrueshme, e sigurtë dhe e mirëmbajtur. Të gjitha mekanizmat dhe pajisjet që ofrohen të jenë funksionale dhe të padëmtuara.
	6	Dhomat, ambientet e përbashkëta, korridoret dhe vendet ku kalohet, të mbajtura pastër në çdo kohë.
	7	Të gjithë tualetet dhe dhomat e dusheve pastrohen çdo ditë dhe kontrollohen për të siguruar standardet e përshatshme të pastërtisë!
	8	Gjendje e mirë dhe ndriçim i përshtatshëm i fasadave dhe ambienteve të mbikqyrura prej bujtinës
II. Ambienti i përbashkët/për publikun	9	Shërbimi i mirëmbajtjes të ofrohet jo më pak se 12 orë në ditë
	10	Të gjitha pajisjet elektrike ose të gazit duhet të mirëmbahen, të jenë në vend të sigurtë dhe në gjendje të mirë pune.
	11	Të disponojë një zonë mirëseardhjeje.
	12	Pritësi në zonën e mirëseardhjes të jetë i aftë për të komunikuar në Anglisht
Zona e mirëseardhjes	13	Bujtina ofron shërbim check-in nga ora 07.00 – 19.00
	14	Person përgjegjës i arrijshëm në telefon në intervalin kohor 19.00-07.00 (në rastet kur pronari nuk jeton në të njëjtën bujtinë)
	14	Afëshmimi i çmimit dhe çdo shërbim që përshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit,

	ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit.
15	Informacion për zonën, aktivitetet që kryhen, kulturen, traditat, ose atraksione të tjera objekte për të vizituar (psh si muzetë, kështjella, evente, , parqe natyrore, aktivitete miqësore) ²
16	Klientët informohen sakët në formë elektronike ose me materiale të printuara për shërbimet që ofrohen.
17	Regjistrimi i klientëve të bujtinës në një regjistrar të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/kartës së identitetit, nr. e ndëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.
18	Pronari ose personeli duhet të jenë në krye të detyrës gjatë mbërritjes dhe nisjes së klientëve si dhe gjatë kohës së vaktit (mëngjes, drekë/darkë)
19	Klienti njoftohet në kohë për çdo situatë që mund të ndikojë negativisht në qendrimin e tij në bujtinë
20	Akresi në dhomë sigurohet gjatë gjithë qendrimit të klientit në bujtinë
21	Shërbim për mbajtjen/ruajtjen e bagazheve
22	Një tharëse flokësh të jetë në dispozicion të klientëve.
23	Kuti e ndihmës së shpejtë e pajisur siç duhet.
24	Sistem për thirrjen e urgjencës mjekësore.
25	Shënja treguese të vendosura qartë për daljet e emergjencës, dhomat, ashenzorët (nëse ka), receptionin dhe ambiente të tjera.
26	Sistem efektiv i ventilimit: natyral ose mekanik
27	Duhet të ketë një dhomë ndenjeje dhe zone ngrenjeje
28	Në rastin kur në dhomat e gjumit nuk ka televizorë, duhet të ketë një të tillë në një dhomë/sallë ndenjeje që ka mobilje të rehatshme
29	Korridorët dhe shkallët të lira nga çdo pengesë.
30	Niveli i ndriçimit në të gjitha hapësirat publike duhet të jetë i përshtatshëm për siguri dhe rehati. Shkallët dhe shesh-pushimet duhet gjithashtu të kenë dritë të mjaftueshme gjatë natës.
III. Dhomat e gjumit për klientët	
31	Secila dhomë të ketë hyrje të veçantë dhe të pavarur ³ dhe të tregohet me numra ose me shenja të tjera.
32	Nuk lejohen shtrëtor të mbivendosur (tip marinari) dhe shtrëtor portativë ⁴
33	Numri maksimal i: - shtrëtorëve shtesë: 2, - personave në dhomë: 4
34	Sipërfaqja minimale e dhomës akomoduese për një person, duke përfshiruar banjon (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë) është 9 m ² dhe ka hapësirë për të siguruar lëvizjen e lehtë nëpër dhomë.
35	Sipërfaqja minimale e zonës së kuzhinës për dhomat për një person, duke përfshiruar banjon (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë) kur kemi akomodim me vetëshërbim ⁵ është 8 m ²

*Standardi i hapësirës së dhomës

	36	Sipërfaqja minimale e dhomës akomoduese për dy persona, duke përfshiruar banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë) është 13 m ²
	37	Sipërfaqja minimale e zonës së kuzhinës për dhomat për dy persona, duke përfshiruar banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë) kur kemi akomodim me vetëshërbim ⁶ është 12 m ²
	38	Sipërfaqe dhome shtesë prej 3 m ² për çdo person tjetër të shtuar
	*Kriteret për sipërfaqet nuk janë të vlefshme për shtëpitë karakteristike tradicionale dhe të shpallura si Monumente Kulture	
Shtrati (Përmasat dhe Cilësia)	39	Përmasa minimale e shtrazit tek: 80 cm x 190 cm;
		Përmasa minimale e shtrazit dopio: 140 cm x 190 cm
	40	Shtrajt: 2 çarçafë, këllëf jastëku, batanije dhe mbulesë
	41	Jastëk shtesë për çdo person sipas kërkesës
	42	Batanije shtesë për çdo person sipas kërkesës
	43	Shtrajt ndërron në paktën njëherë në javë ose sipas kërkesës së klientit dhe për çdo klient të ri
	44	Të gjithë detyshkët duhet të jetë të rehatshëm, të pastër, pa njolla apo erë, në gjendje të mirë.
	45	Të gjithë shtrëtit duhet të rregullohen çdo ditë
	46	Dritare/ballkon që lejon hyrjen e dritës natyrore dhe ajrosjen në dhomë.
	47	Perde e errët (ose e ngjashme) që bllokton dritën natyrore/dritat e jashtme
Mobilimi dhe komoditeti i dhomës	48	Një karigje ose kolltuk
	49	Së paku një komodinë për çdo dy persona ose dy komodinë për çdo 3 persona
	50	Një kosh mbeturinash
	51	Një pasqyrë vertikale për veshje
	52	Dollap rrobash me 5 varëse rrobash për person
	53	Sistem ngrohjeje dhe ftohjeje efektiv
	54	Dritë leximi individuale
	55	Të paktën një dritë të kontrolluar që nga nga dera
	56	Priza elektrike në dispozicion për përdorim të sigurt të pajisjeve elektrike individuale dhe atyre që ofrohen nga bujtina
	57	Të sigurojë minimalisht thirrjet telefonike brenda vendit
Shërbime shtesë në dhomë	58	Të sigurojë shërbimet e mirëmbajtjes
	59	Të disponojë një udhëzues për ndihmën në raste të emergjencës
	60	Plani i evakuimit i vendosur prapa derës së çdo dhome
	61	Një gotë uji për çdo person

	62	Udhëzime të shkruara se si të kontaktohet pronari/personeli në rast emergjence gjatë 24 orëve
IV. Tualeti, dushet, dhe pajisjet sanitare		
Struktura dhe Pajisjet sanitare	63	Një tualet në kat dhe së paku një për çdo 6 persona ⁷
	64	Ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë
	65	Letër higjienike
	66	Lavaman
	67	Sapun të pakeluar ose sapun të lëngshëm
	68	Kosh për mbetjet higjienike
	69	Dera e tualetit të jetë me mbyllje nga brenda
	70	Të gjithë tualetet duhet të jenë të ndriçuar mirë dhe temperatura e ambientit të jetë e përshtatshme
	71	Faqet anësore dhe dyshemeja e dushit/vaskës e veshur me material izolues (të papërshkueshëm nga uji)
	72	Mur me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike etj.) deri në lartësinë 1,20 m
	73	Dy peshqirë për person (fytire dhe trupi) dhe varëset përkatëse
	74	Marrja e masave kundër rrëshqitjes në ambientet sanitare
	75	Aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit me pasqyrë
	76	Çdo zonë sanitare të ketë një sistem të efektivshëm të ventilimit natyral ose mekanik
Lavamani në dhomë	77	Një varëse rrobash për dushet e përbashkëta
	78	Priza elektrike për përdorim të sigurt të të gjitha pajisjeve elektrike
	79	Kur një lavaman është i vendosur në dhomën e gjumit duhet të ketë:
	80	Aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit me pasqyrë.
	81	Një mbajtëse peshqiri ⁸
V. Zona e ngrënies	82	Një peshqir duarsh ose pajisje për tharjen e duarve
	83	Sapun të pakeluar ose sapun të lëngshëm në dhomë
	84	Dhomë/mjedis për ngrënien e mëngjesit me kushte të përshtatshme për akomodimin e një kapaciteti maksimal klientësh.
	85	Të ofrohet mëngjes i mjaftueshëm ⁹ dhe shërbyer sipas standardeve
	86	Aksesorë për ngrënien të përshtatshme dhe të mjaftueshme për t'i shërbyer një kapaciteti maksimal klientësh, të ulur në dhomë/mjedisin e ngrënies së mëngjesit. ¹⁰
	87	Aksesorët për ngrënien janë të padëntuar dhe i përmbahen kushteve optimale higjienike.
	88	Një kuzhinë ose ambient, për përgatitjen e ushqimit të mëngjesit.
Shërbimi mëngjesit		Hapësirë/mjedis të pastër, të rregullt dhe të përshtatshëm për magazinim.

Dreka/Darka (nëse ofrohet)	89	Ushqimet që shërbehet përpunohet, përgatitet dhe trajtohet sipas rregullave për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet/dëmtimet si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore ose shtazore (vërtetuar nga dokumentet e lëshuara nga autoritetet përgjegjëse) ¹¹
	90	Ofrim i ushqimit vegjetarian sipas kërkesës
VI. Kuzhina (në rastet e akomodimit me vetëshërbim)¹²		
Pajisjet e kuzhinës	91	Frigorifer
	92	Lavapjatë me ujë të rrijedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë
	93	Një furrë dhe sobë me të paktën 2 pllita
	94	Një aspirator
	95	Servis gatimi dhe ngënie ¹³ për të paktën 6 persona
	96	Mjete për të siguruar higjienën
	97	Të paktën dy peshqira kuzhine
	98	Një mbulesë tavoline dhe të paktën 6 peceta
VII. Menaxhimi dhe staff		
	99	Bujtina duhet të jetë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të një personi, të aftë për ta drejtuar atë sipas standardeve të vendosura në këtë rregullore.
	100	Staffi duhet të jetë i veshur në mënyrën e duhur, pastër dhe të jenë të kujdesshëm në çdo kohë.

¹ Tualetet dhe dhomat e dushëve janë të pastra dhe me aromë të freskët.

² Ky informacion mund të jepet në formën e broshurave, revistave ose nëpërmjet komunikimit verbal

³ Dhomat që kanë komunikim me njëra tjetrën do të quhen si një dhomë e vetme.

⁴ Ky kriter nuk është i vlefshëm për shtëpitë karakteristike tradicionale dhe të shpallura si Monument Kulture.

⁵ Një akomodim vetëshërbimi, mund të përfshijë si një shtëpi pushimi ose vilë e pastër, e rehatshme, e mobiluar dhe e pajisur me mjete për të përgatitur dhe gatuar vetë ushqimin.

⁶ E veçshme kjo sipërfaqe minimale e zonës së kuzhinës edhe për zonën e kuzhinës që përdoret nga persona të dhomave të ndryshme

⁷ Në rastet kur dushi/vaska dhe WC janë në ambiente të ndara, vlen po i njëjti rregull.

⁸ Një radiator nuk është i pranueshëm, por një unazë për mbajtjen e peshqirit ose një raft afër radiatorit është i përshtatshëm.

⁹ Mëngjes i mjaftueshëm ofron të paktën një pije të ngrohtë (kafë ose çaj), një lloj buke, drithëra, gjalpë, reçel/mjaltë/lloj tjetër kremrash të embël, vezë, qumësht

¹⁰ Gota, pjata, filxhanë, peceta, servis i ngjënës.

¹¹ Preferohet që për vaktin e drekës apo të darkës të ofrohen ushqime tradicionale të zonës

¹² Në këtë rast, nuk aplikohen kriteret për shërbimin e mëngjesit, drekës dhe darkës.

¹³ Të tilla si tigan, tenxhere, tavë, pjata, servis ngënje, filxhanë, gota etj.

Aneksi 1/b

Tabelë klasifikimi - Fjetinë (Hostel)

Në mënyrë që një strukturë akomoduese të klasifikohet si “Fjetinë” duhet që të përmbushë të gjithë kriteret e detyrueshme të nivelit përkatës të klasifikimit.				
Fushat	Nr.	Kriteret	Standard	Komfort
I. Të përgjithshme				
Ndërtesa dhe gjendja e përgjithshme	1	Struktura akomoduese duhet të jetë një godinë e veçuar. Godina të ketë një konstruksion të qëndrueshëm, të sigurt dhe të jetë e mirëmbajtur tërësisht.	D	D
	2	Të jetë e përshtatshme për aktivitetin që zhvillohet dhe e pajisur për qëllime të ofrimit të shërbimeve të fjetinës.	D	D
	3	Struktura akomoduese duhet të përdoret për akomodim të klientëve që paraqiten me ose pa rezervim duke i siguruar atyre shërbim në orare të arsyeshme.	D	D
	4	Ndriçim i mjaftueshëm jashtë dhe brenda godinës për të siguruar një funksionim normal të aktiviteteve si p.sh. lexim, ngrënie, etj.	D	D
	5	Sistem ngrohje/ftohje që siguron një temperaturë të rehatshme në të gjithë ambientet e brendshme si dhe ventiliim natyral ose mekanik.	D	D
	6	Strukturat akomoduese mbi 3 kate duke përfshirë katin përçhes duhet të kenë asensor		D
	7	Rampë në hyrje të strukturës akomoduese		D
Mirëmbajtja, Pastërtia dhe Siguria	8	Të gjitha ambientet pastrohen dhe kontrollohen 3 herë në javë për të siguruar një standard të lartë pastërtie.	D	
		Të gjitha ambientet pastrohen dhe kontrollohen çdo ditë për të siguruar një standard të lartë pastërtie.		D
	9	Shërbimi i mirëmbajtjes të ofrohet 8 orë në ditë	D	
	10	Shërbimi i mirëmbajtjes të ofrohet 12 orë në ditë		D
		Hyrie e kontrolluar në portën kryesore për të mundësuar sigurinë e klientëve dhe të sendeve të tyre.	D	D

	11	Ambient për magazinimin e materialeve dhe pajisjeve për përdorim të brendshëm si p.sh. materiale pastrimi, çarçafë dhe jorganë shtesë, etj.	D	D
II. Ambienti i përbashkët/për publikun				
Zona e pritjes	12	Zona e pritjes e pajisur me tryezë ose banak për t'u shërbyer klientëve.	D	D
	13	Regjistrimi i klientëve të fjetinës në një regjistrar të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/kartës së identitetit, nr. e nënqendrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.	D	D
	14	Kënd për paraqitjen e materialeve informative të përditësuara, si dhe oferta për aktivitete të ndryshme të organizuara.	D	D
	15	Person përgjegjës i aftë të komunikojë anglisht dhe të asistojë nevojat e klientëve.	D	D
	16	Person përgjegjës për të shërbyer të paktën 12 orë në ditë	D	D
	17	Procedura të qarta dhe lehta të mënyrës së pagesës. Rezervimet duhet të jenë në dispozicion përmes formave të ndryshme (telefon, e-mail, prenotim direkt, online etj.)	D	D
	18	Afshim i informacionit për rregullat, oraret dhe shërbimet e funksionimit të fjetinës.	D	D
	19	Sistem i sigurt për depozitat e sendeve personale.	D	D
	20	Shërbim për mbajtjen/ruajtjen e bagazheve.	D	D
	21	Kueta e ndihmës së shpejtë në reception.	D	D
	22	Telefon publik në zonën e pritjes dhe afshim i numrave të emergjencës. Udhëzime të shkruara se si të kontaktohet personeli në raste emergjence gjatë 24 orëve.	D	D
	23	Afshim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihen, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit.	D	D
Dhoma e përbashkët	24	Zona e pritjes duhet të jetë e ndarë nga zona e kuzhinës / ngjënies.	D	D
	25	Struktura duhet të ketë të paktën një dhomë të përbashkët.	D	D
		Dhoma e përbashkët duhet të ketë përmasa jo më pak se 17 m ² për 20 persona dhe jo më pak se 0.5 m2 për çdo person më shumë.		D
	26	Dhoma e përbashkët duhet të përmbajë mobilje dhe pajisje funksionale.	D	D

III. Dhomat e gjumit për klientët				
Të përgjithshme	Numri maksimal i personave në dhomë: 12		D	
	Numri maksimal i personave në dhomë: 6		D	
27	Numri maksimal i personave në dhomë: 6		D	
28	Të gjitha dhomat kanë hyrje të veçantë dhe të pavarur ¹ .		D	
29	Fjetina duhet të ketë fjetore dhe dhoma gjumi private.		D	
30	Dhomat të kenë numër ose emër, të vendosur në mënyrë të qartë.		D	
31	Fjetoret duhet të ndahen sipas gjinive. Nëse nuk është e mundur, klientët duhet të informohen në kohën e rezervimit.		D	
32	Nuk lejohet akomodimi të miturve të pashoqëruar në fjetoret me gjini të përziera. Në fjetore duhet të afshohet qartë ky shënim.		D	
33	Hapësirë e njafueshme në dhomë për të lëvizur lirisht. Dhoma duhet të jetë në madhësinë e duhur dhe e mobiluar për të siguruar nivele normale të përdorimit.		D	
	Një dhomë e mirë-planifikuar që ofron nivel të lartë rehatie për të gjithë klientët. Të gjitha pajisjet të pozicionuara në vende të përshtatshme.		D	
Standardi i hapësirës së dhomës	34	Nëse shtretërit përbëhen vetëm nga një njësi (tek), hapësira organizohet duke ruajtur raportin 50% sipërfaqe e lirë.	D	D
	35	Nëse shtretërit përbëhen nga dy njësi (marinar) ose përzierje e të dy llojeve, hapësira organizohet duke ruajtur raportin 60% sipërfaqe e lirë.	D	D
	36	Sipërfaqja minimale e dhomës për një person, duke përfshiruar banjën (nëse kjo e fundit ofrohet)	5 m ²	7 m ²
	37	Sipërfaqja minimale e dhomës për dy persona, duke përfshiruar banjën (nëse kjo e fundit ofrohet)	7 m ²	10 m ²
	38	Sipërfaqe dhome shesë e nevojitur për çdo person tjetër të shtuar me shtrat tek/marinar	3 m ² /2 m ²	3.5 m ² /2.5 m ²
	39	Përmasa minimale e shtrait tek: 80 cm x 190 cm	D	D
	40	Përmasa minimale e shtrait dopio: 140 cm x 190 cm	D	D
Shtrati (Përmasat dhe Cilësia)	41	Shtrojet: 2 çarçafë pambuku të pastër njëngjyrësh, mbulesë/jorgan, këllëf jastëku.	D	D
	42	Një jastëk për person.	D	D
	43	Jastëk /batanije shesë për çdo person sipas kërkesës.	D	D
	44	Të gjitha shtrojet duhet të jenë të pasura dhe në sasi të njafueshme, në bazë të sezonit dhe nevojave të klientit.	D	D

	45	Shtrojet ndërrohen për çdo klient të ri dhe të paktën një herë në javë ose sipas kërkesës së klientit (me ose pa pagesë)	D	
		Shtrojet ndërrohen për çdo klient të ri dhe të paktën njëherë në javë ose sipas kërkesës së klientit pa pagesë.		D
Mobilimi dhe komoditeti i dhomës	46	Dritare/ballkon për ndriçim natyral si dhe ventilin natyral ose mekanik.	D	D
	47	Perde e errët (ose e ngjashme) që bllokton dritën natyrale/dritat e jashtme.	D	D
	48	Tryezë, komodinë ose mobilje të ngjashme.		D
	49	Priza elektrike në dispozicion për përdorim të sigurtë të pajisjeve elektrike individuale	D	D
	50	Kosh mbeturinash.	D	D
	51	Dollap ose sirtar me çelës për ruajtjen e sendeve personale.		D
	52	Varëse për trobat në një numër të mjaftueshëm.		D
	53	Mundësi për akses individual në dhomë (çelës, kartë, etj.)	D	D
	54	Një llampë nate për secilin shtrat.		D
IV. Tualet, dushet, dhe pajisjet sanitare				
	55	Një banjo në kat dhe së paku një për çdo 6 persona	D	
		Një banjo në kat dhe së paku një për çdo 4 persona		D
		Në rastet kur dushi dhe WC janë në ambiente të ndara, duhet të ketë një WC dhe dush për çdo 8 persona ose nga një në çdo kat.	D	
	56	Në rastet kur dushi dhe WC janë në ambiente të ndara, duhet të ketë një WC dhe dush për çdo 6 persona ose nga një në çdo kat.		D
Të përgjithshme	57	Në rastet kur dushi dhe WC janë në ambiente të ndara, duhet të ketë lavaman në secilin prej tyre.	D	D
	58	Duhet të ketë privatësi mes gjinive në dush dhe tualete.	D	D
	59	Ambientet e dushëve dhe të dhomave të zhveshjes duhet të kenë ndarëse ose dritare opake për të siguruar privatësi.	D	D
	60	Të gjitha pajisjet sanitare duhet të jenë të funksionale dhe të mirëmbajtura.	D	D
	61	Ujë i rrjedhshëm i ftohtë dhe i ngrohtë.	D	D

	62	DysHEME me material kundër rrëshqitjes dhe muret me material izolues, që pastrohet dhe mirëmbahet lehtë.	D	D
Pajisjet sanitare	63	Ambientet sanitare duhet të jenë të pajisura si më poshtë: pasqyrë, varëse peshqiri dhe trobash, kapak WC-je, mbajtëse sapuni dhe sapun të pakeluar ose të lëngshëm, letër higjienike në mbajtësen përkatëse, kosh për mbejet higjienike.	D	D
	64	Dera e tualetit të jetë me mbyllje nga brenda.	D	D
	65	Faqet anësore dhe dysHEMEja e dushit e veshur me material izolues (të papërshkueshëm nga uji).	D	D
V. Zona e ngrënies				
Shërbimi i mëngjesit, Dreka/Darka (nëse ofrohet)	66	Përmasat e zonës së ngrënies si dhe serviset e ngrënies (pjata, gota, lugë, pirunë etj.) të jenë në proporcion me kapacitetin e fjetores.	D	D
	67	T'ryezat dhe karriget duhet të jenë në numër të mjaftueshëm dhe të vendosura në mënyrë të përshtatshme për të mundësuar kalim pa pengesa të stafit.	D	D
	68	Serviset e ngrënies (pjatë, gota, mbulesat etj.) duhet të jenë në gjendje të mirë.	D	D
	69	Shërbimi nuk duhet të kalojë përmes zonave të përbashkëta që përdoren si zonë pritjeje ose korridore kryesore.	D	D
	70	Ushqimi mund të jetë i kufizuar në zgjedhje, por duhet të jetë i një cilësie të mirë, që i përmbahet standardeve të përcaktuara nga legjislacioni. ²	D	
		Ushqimi duhet të jetë me një gamë të gjerë zgjedhjesh në menu dhe i një cilësie të mirë, që i përmbahet standardeve të përcaktuara nga legjislacioni. ³		D
	71	Duhet të ketë personel të mjaftueshëm në dispozicion për të shërbyer.	D	D
	72	Nëse kërkohet në kohën e rezervimit, duhet të ketë të paktën një opion për ofimin e një ushqimi vegetarian.	D	D
VI. Kuzhina me vetëshërbim (nëse ofrohet)				
Pajisjet e kuzhinës	73	Mjedis përgatitje dhe gatimi për klientët, për të mbajtur, ruajtur, përgatitur dhe konsumuar ushqime të ngrohta dhe të ftohta, i cili përmbush kriteret e higjienës.	D	D
	74	Të ketë përmasa të përshtatshme në proporcion me kapacitetin e fjetinës dhe pajisjet e saj të jenë në gjendje funksionale.	D	D
	75	Frigorifer ose njësi ftohëse.	D	D
	76	Tavolinë ose njësi për përgatitjen e ushqimit me sipërfaqe të padëmtuar dhe që pastrohet lehtësisht.	D	D
	77	Pajisje gatimi.	D	D
	78	Lavaman me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë.	D	D

	79	Kosh plehrash me kapak në vendndodhje të përshatshme. Nuk lejohet të mbahen plehurat në kuzhinë dhe duhet të hiqen rregullisht.	D	D
	80	Pjata, gota, pirunë, lugë, thika në sasi të mjaftueshme që të mbulojë nevojat e klientëve që akomodohen.	D	D
	81	Kuzhina duhet të jetë e vendosur pranë ose lehtësisht e aksesueshme nga zona e ngjërës.	D	D
VII. Shërbime shesë				
	82	Ambient i përshatshëm për larjen dhe tharjen e robave si dhe mjaftueshëm makina larëse për të mbuluar nevojat e klientëve.	D	D
	83	Veprimtari argëtuese ⁴ .	D	D
VIII. Menaxhimi dhe stafi				
